



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 03.12.2013, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Eduard Shalsi – kryetar komisioni**

**Rendi i ditës:**

1. Seancë dëgjimore me Federatën e Gjuetarëve të Shqipërisë.

**Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Robert Bitri, Artan Gaçi, Ardian Turku, Agron Duka, Fatmir Toçi, Besnik Baraj, Dashamir Tahiri, Besnik Dushaj, Gjergji Papa, Kozma Dashi, Helidon Bushati, Parid Cara, Ervin Koçi, Namik Kopliku, Rakip Suli dhe Ilir Xhakolli.

**Mungojnë:**

Genc Ruli, Piro Kapurani, Artur Bushi, Voltana Ademi, Sherefedin Shehu, Gentian Bejko dhe Sadri Abazi.

**Të ftuar:**

Kujtim Hazbiu – zëvendës-president i Federatës së Gjuetarëve të Shqipërisë dhe kryetar i Shoqatës së Gjuetarëve në Elbasan

Zyhdi Mustafa – zëvendës-president i dytë i Federatës së Gjuetarëve të Shqipërisë dhe kryetar i Shoqatës së Gjuetarëve në Shkodër

Ramazan Gjyla – anëtar i Bordit Drejtues të Federatës së Gjuetarëve dhe kryetar i Shoqatës së Gjuetarëve në Lushnjë

Asqeri Alimeti – anëtar i Bordit Drejtues të Federatës së Gjuetarëve dhe kryetar i Shoqatës së Gjuetarëve në Berat.

Asti Hanxhari - anëtar i Bordit Drejtues të Federatës së Gjuetarëve dhe kryetar i Shoqatës së Gjuetarëve në Durrës

Platon Shabanaj – anëtar i Bordit Drejtues të Federatës së Gjuetarëve dhe kryetar i Shoqatës së Gjuetarëve në Vlorë

Themi Perri – anëtar i Bordit Drejtues dhe sekretar i Përgjithshëm i Federatës së Gjuetarëve

## **HAPET MBLEDHJA**

**Eduard Shalsi** - Fillojmë mbledhjen.

Javën që kaloi ishte programuar për t'u bërë një dëgjese e tillë, por meqenëse zgjati seanca me Federatën e Gjuetarëve dhe të Peshkatarëve, me përfaqësuesit e shoqërive të tregtimit dhe të shitjes së armëve, si dhe me përfaqësuesit e agjencive të gjuetisë sportive dhe turistike, u detyruam që këtë mbledhje ta shtyjmë për sot.

Do t'u uroja mirëseardhjen në Komisionin për veprimtarinë Prodhuese përfaqësuesve të Federatës së Gjuetarëve të Shqipërisë.

Në fillim do të dëgjojmë përfaqësuesit e federatës. Pastaj kolegët e komisionit mund të bëjnë pyetje. Pas përgjigjeve, anëtarët e komisionit rezervojnë të drejtën të bëjnë komente, vërejtje dhe sugjerime mbi ato çfarë do të thoni ju.

Ju lutem, mund të bëni në mënyrë koncize një prezantim të problematikës.

**Kujtim Hazbiu** – Ne ju falënderojmë për këtë nismë shumë të rëndësishme që keni marrë, për domosdoshmërinë e jashtëzakonshme për të mbrojtur faunën në Republikën e Shqipërisë, si një vlerë shumë e madhe e vendit tonë.

Ne sot kemi ardhur për të vetmin qëllim që të jemi pjesë dhe të japim kontributin tonë të përbashkët me ju, si palë e interesuar për të gjetur të gjitha modalitetet dhe format, për të mbrojtur dhe për të parandaluar këtë masakër që ndodh në vendin tonë në lidhje me gjuetinë.

Fjalën e ka zoti Perri, sekretar i Përgjithshëm i Federatës. Në fund edhe ne do të bëjmë konkluzionet tona.

**Them Perri** – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Federata e Gjuetarëve të Shqipërisë ka një anëtarësim me mbi 17 mijë anëtarë, me 38 shoqata, që përfaqësojnë të gjithë qarqet në shkallë rrethi dhe vendi. Federata jonë është anëtare me të drejta të plota në Federatën Europiane të Gjuetisë dhe të Konservimit të Jetës së Egër me qendër në Bruksel. Ajo është anëtare me të drejta të plota në Bashkimin Ndërkombëtar të Federatave të Gjuetarëve Botërorë me qendër në Hungari, që përfaqësojnë 87 shtete në pesë kontinente me gati 1500 anëtarë, ku bëjnë pjesë federata, organizata mjedisore, individë dhe grupe që përfaqësojnë interesim për zhvillimin dhe menaxhimin e botës së egër.

Me një përvojë mbi 60-vjeçare në fushën e zhvillimit dhe të menaxhimit të gjuetisë, ne kemi një zhvillim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit, me Policinë e Shtetit, me njësitë e qeverisjes vendore, si edhe me të gjitha organizatat mjedisore në Shqipëri dhe jashtë vendit, me lidhje bashkëpunimi e organizimi të veprimtarive të përbashkëta me federatat rajonale e më gjerë, si ato të Rumanisë, Bullgarisë, Greqisë, Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Kroacisë. Në shkallë kombëtare, përmes veprimtarive tona, ne promovojmë gjuetinë e qëndrueshme si një mjet i ruajtjes së natyrës dhe të traditave me vlerë të Shqipërisë.

Aktualisht kur po diskutojmë për të miratuar ose jo një moratorium, situata e gjahut dhe e gjuetisë ndodhet jashtë kontrollit dhe në një kaos total. Në Shqipëri mjafton të kesh një armë gjahu e mund të gjuash ku të duash dhe si të duash, në çdo ditë të javës, mund të vrasësh sa të duash e kur të duash, ditën, natën dhe jashtë sezonit, madje edhe kur kafshët dhe shpendët e egër janë në folezim apo me të vegjël në bark. Përdoren të gjitha mjetet e sofistikuara, aparate zëndjellës e regjistratorë të ndaluar me ligj. Ushtrohet një gjueti barbare me drita dhe prozhektorë natën, për pasojë shumë specie janë zhdukur dhe shumë të tjera janë në limite kritike.

Jo për t'u justifikuar, por Federata e Gjuetarëve të Shqipërisë ka vite që ka denoncuar këtë gjueti kriminale, por fatkeqësisht deri tani nuk është bërë asgjë. Ka më se 20 vjet që nuk është investuar asnjë qindarkë në rezervatet e gjuetisë që shërbejnë për ripopullimin e zonave të tjera. Nuk ka asnjë lloj përkujdesje për zonat e mbrojtura dhe nuk është zbatuar asnjë projekt-pilot nga shteti apo nga Bashkimi Europian. Përkundrazi në këto zona ushtrohet presion, trysni dhe gjueti e kundërligjshme më shumë se në zonat e tjera.

Në kushtet e emergjencës, duhet patjetër urgjentisht nga vendimmarrja dhe ekzekutivi të merren masa me efekt të shpejtë e polivalent për mbarëvajtjen e sektorit të gjuetisë, prej të cilave më kryesoret po i rendisim më poshtë.

Edhe pse është një aktivitet që bazohet mbi shfrytëzimin e njeriut prej burimeve natyrore më delikate e me vlerë të vendit, atë të faunës së egër, gjuetia është parë nga vendimmarrësit me të lartë të shtetit shqiptar, por edhe nga shumica e popullit, si një mëkat i vogël i një pasioni të madh, i cili jo vetëm do toleruar, por ajo që është më e keqja dhe më negativja mund të falet edhe kur ajo masakron, pasi mendohet se nuk i bën

dëm direkt askujt, “përveç disa kafshëve të egra, të cilat, edhe po i vramë, natyra do të na i sjellë përsëri”.

Kjo gjë vjen nga mungesa e kulturës dhe e traditës së vërtetë botëkuptimore në këtë fushë, por edhe nga moszbatimi skandaloz i ligjeve. Gjuetia në vendin tonë është në një gjendje kaotike, ku çdo njeri që dëshiron gjuan dhe vret çfarë të mundë, çfarë të dojë, dhe kur të dojë, mjafton të ketë një armë gjuetie që mund ta blejë e të sigurojë për të një leje mbajtjeje nga organet e policisë pa vështirësi, ku lulëzon kontrabanda dhe gjuetia e paligjshme, që nuk merr parasysh asgjë, ku e ashtuquajtura gjueti turistike me të huajt bën kërdrinë me lejen e shtetit, ku tregtia dhe eksporti klandestin i gjahut të vranë bëhet nëpërmjet porteve dhe aeroporteve tona, edhe pse ekzistojnë rregulla dhe ligje, shoqata gjuetarësh e ndërmarrje pyjesh, lëvizje ekologjike, edhe pse Shqipëria ka firmosur konventa ndërkombëtare në mbrojtje të natyrës dhe rrethohet nga vende europiane të cilat, lidhur me këto probleme, janë pakrahasueshmërisht larg nesh.

Për ju, zotërinj deputetë, ne kemi dhënë ndonjë revistë, ndonjë CD, me foto, me një historik të shkurtër të federatës sonë, por ajo që duam të komentojmë, meqenëse jemi të gjuetia turistike, është se flasim me shumë kompetenca se gjuetia e të huajve në Shqipëri është bërë një gangrenë, sidomos kohët e fundit është kthyer në një masakër. Çfarë është më e keqja bëhet një propagandë shumë e keqe në shtetet fqinje sikur në Shqipëri është parajsë. Do t’ju tregoj dy-tri foto për ta ilustruar këtë gjë. Këta zotërinj këtu janë nga Sardenja. Kanë ardhur në Shqipëri dhe kanë gjuajtur. Kur janë kthyer në Sardenjë, kanë bërë koment: “E bukura Shqipëri! Te ne nuk lejohet të vrasësh një mëllenjë, ndërsa në Shqipëri vret çfarë të duash, sa të duash dhe kur të duash. Viva Albania!”. Sa poshtëruese është për ne gjuetarët shqiptarë kur ky “bandill” që ka ardhur nga shteti fqinj, ka mbushur karrocën me gjah të vranë në Shqipëri dhe e poston në shtetin e tij atë që bëhet në Shqipëri. Edhe ky zotëria këtu, ka një mal me gjah, me kafshë dhe me shpendë të egër. Kjo është gjendja reale e gjuetisë së të huajve në Shqipëri.

Si rezultat i këtyre dukurive u zhdukën ose janë në rrugën e zhdukjes thujtë të gjitha llojet tradicionale të gjahut, si kaprolli, dhia e egër, derri i egër, thëllëza e fushës, fazani, duke dalë përfundimisht nga lista e kafshëve që mund të gjuhen në vendin tonë. Janë në shkatërrim e sipër habitatet më të mira natyrore të këtyre llojeve si pasojë e një shkatërrimi progresiv dhe i një trajtimi të papërgjegjshëm që u është bërë pyjeve,

kullotave dhe lagunave, që po mbillen me vila dhe hotele, disa prej të cilave janë zaptuar nga të fortët edhe me tela, të cilat janë mjedisi natyral i faunës së egër.

Një përkeqësim i tillë vazhdon prej më se 20-vjetësh, duke pasur kulmin në dekadën e fundit, megjithëse po prej kaq kohësh shumica e këtyre kafshëve, *de juro*, janë mbrojtur dhe mbrohen nga ligjet e shtetit, duke përfshirë edhe aktualin.

Në të njëjtën kohë konstatohet se këto lloje, por edhe shumë të tjera në të gjitha vendet e Europës së qytetëruar, madje edhe te komshinjtë tanë, zhvillohen e përparojnë jo vetëm duke ofruar kënaqësinë e gjuetisë, por edhe të ardhura të rëndësishme për vendin e tyre. Fatkeqësisht te ne, akoma vazhdojmë ta quajmë sport, madje Ministria e Kulturës dhe e Sporteve ka ngritur një Federatë të Gjuetarëve, gjë që nuk ndodh në asnjë vend europian. Mjafton të përmendim faktin se në Gjermani vlera e gjahut të vrarë brenda të gjitha rregullave, pa prekur fondin e popullatave, në një vit arrin mesatarisht në mbi 180 milionë euro. Në Francë prurjet financiare nga aktiviteti i gjuetisë arrijnë mesatarisht në mbi 2 miliardë euro, me mbi 23 milionë të punësuar. Kjo për të kuptuar dimensionet e këtij aktiviteti që te ne konsiderohet i neglizhueshëm dhe përvetësohet pa të drejtë vetëm nga disa “të fortë” që e kanë shndërruar gjuetinë në një çiflig klandestin që milet por nuk deklarohet, dhe kjo bëhet në emër të të drejtave të njeriut.

Që të arrihet vjelja e gjahut me anë të gjuetisë, duhet të konsiderohet jo sport që kënaq një pasion të atyre që e kanë, por edhe si një degë prodhimi e cila përbri kënaqësisë së këtij pasioni, i jep ekonomisë së vendit një sasi mishi të cilësisë së lartë, lëkurët dhe trofetë e gjahut, të cilat janë gjithashtu me vlerë të madhe e të rrallë.

Prandaj kjo gjë kërkon shkencë dhe teknikë, fonde dhe personel të specializuar, ligje dhe rregulla të forta. Nga ana tjetër duhet kuptuar qartë se edhe në vendet më të zhvilluara të botës, gjuetia si aktivitet dhe gjahu si e mirë materiale, nuk mund të jenë të disponueshëm për të gjithë qytetarët e një vendi.

Kapacitetet e gjuetisë nuk mund të kënaqin kërkesat e krejt popullatës mbi 6 miliardëshe të globit. Kjo është arsyeja që ushtrohet vetëm nga një pjesë e shoqërisë, nga njerëzit e apasionuar e me njohuri të plota të bashkuar, me shoqata të cilat organizojnë e kontrollojnë këto aktivitete dhe sigurojnë qarkullimin selektiv të anëtarësisë, sipas rregullave dhe kërkesave të rrepta të përcaktuara mirë, të cilat lidhen me njohuritë dhe përgatitjen e tyre, duke siguruar me këtë respektimin e të

drejtës së çdokujt për t'u marrë me gjueti. Prej këtej rrjedh edhe fakti që në çdo vend të qytetëruar numri i gjuetarëve të regjistruar në shoqata koordinohet me kapacitetet prodhuese të ekonomisë së gjahut të shtetit përkatës dhe jo si te ne, që sot kemi një numër anëtarësh që shkon nga 12 deri 17 mijë gjuetarë të regjistruar dhe mbi 150 mijë armë gjahu me të cilat mund të gjuhet gjatë gjithë ditëve të vitit.

Të nderuar deputetë, ju e keni përpara në tavolinë materialin. Dua të theksoj vetëm disa gjëra që ka shkruar edhe Federata Europiane e Gjuetisë në letrën që u ka nisur autoriteteve më të larta të shtetit shqiptar. Një kopje të letrës jua kam dorëzuar. Kjo federatë kërkon me përparësi që të ndryshohet menjëherë ligji i gjuetisë. Federatat dhe shoqatat e tjera duhet të kenë hapësirën e tyre ligjore për të punuar, ashtu sikurse edhe simotrat tona në shtetet e tjera.

Po kaloj direkt te pjesa se çfarë mendon Federata Shqiptare e Gjuetisë për ta rregulluar gjendjen në të cilën jemi katandisur. Kemi organizuar disa konsulta nëpër shoqatat e gjuetarëve, kemi mbledhur Këshillin Kombëtar të Federatës të Gjuetarëve të Shqipërisë dhe në mënyrë, pak a shumë, unanime ne kërkojmë që, në qoftë se nuk do të jetë e mundur, atë punë që ne kërkojmë këtu, mund ta zëvendësojë shumë mirë, moratoriumi që kërkon që gjuetia të mbyllet për dy vjet. Në asnjë vend europian, deri tani, sado keq kanë qenë këto shtete, për sa i përket faunës së egër, gjuetia nuk është mbyllur. Madje edhe në kohën komunizmit nuk kishin çfarë t'i bënin gjuetisë, dhe u vulosën armët e gjahut, por gjuetia nuk u mbyll. Kërkesa jonë e parë është që duhet të hartohet dhe të miratohet sa më shpejt që të jetë e mundur ligji i gjuetisë, duke marrë parasysh në mënyrë kritike propozimet e bëra nga FACE (Federata Europiane e Gjuetisë dhe Konservimit të Botës së Egër) dhe Federata e Gjuetarëve të Shqipërisë. Sikundër edhe në shtetet e tjera Europiane, të këtë me ligj një federatë në shkallë kombëtare (dhe një shoqatë në rrethe), veprimtaria e së cilës të kushtëzohet vetëm duke qenë anëtar i federatës. Konkretisht, në mbledhjen e fundit të bordit drejtues që kemi pasur me Federatën Europiane të Gjuetisë, presidenti i Federatës Europiane na ka thënë: “Ne jemi të gatshëm të sjellim në Shqipëri specialistët më të mirë të Federatës Europiane, por edhe nga Bashkimi Europian, që t’ju ndihmojnë për të hartuar një ligj bashkohor, për sa i përket gjuetisë dhe faunës së egër”. Gjithashtu, gjuetia e të huajve në Shqipëri ka arritur pikën më kritike: është jashtë kontrollit. Në qoftë se ka pasur 20 agjenci turistike, të cilat

nuk mund të quhen kurrë “turistike”, sivjet kanë paguar vetëm tetë, por mbi 40 prej tyre kanë punuar në të zezë. Gjuetarët e huaj vijnë pa u çelur sezoni i gjuetisë dhe ikin një muaj më mbresa sezonit të gjuetisë dhe nuk u ka hyrë gjemb në këmbë. Kuptohet, të mbështetur nga të fortët apo nga ndonjë që mendon akoma se e ka faunën e egër në Shqipëri çifligun e vet. Prandaj, Shoqata e Gjuetarëve të Shqipërisë, pra ne komuniteti i gjuetarëve, do të dëshironim shumë që ju të shikoni mundësinë që kjo lloj gjuetie të ndalohet për katër vjet, sepse po e shkatërron gjahun në Shqipëri, duke u mbështetur dukshëm në korrupsionin e faunës së egër. Edhe nga Federata Europiane e Gjuetisë propozimi është i njëjtë. Ndërkohë, duhet të ndalohet me ligj tregtimi i mishit të kafshëve dhe shpendëve të egra nëpër lokalet tona. Kjo është një dukuri jashtë mase e keqe, mbase edhe në ndonjë anëtar, por edhe ata që nuk janë përfshirë te ne të cilët nuk thonë më: “Hajde të ikim për gjah”, ose: “Hajde se do ikim për punë”, por gjuajnë gjithë ditën dhe gjithë natën, mbushin thasët dhe shkojnë e i shesin nëpër lokale, të cilat janë bërë burim i keq edhe për gjuetarët e tjerë që janë të ndërgjegjshëm. Megjithëse është miratuar një ligj për armët e gjahut, për të cilin na u mor mendimi në mënyrë të pjesshme, por asnjë presje nuk u mor parasysh, se çfarë kushtesh duhet të plotësojë një qytetar për të blerë një armë gjahu në Shqipëri. Prandaj themi që të kondicionohet me ligj blerja e një arme gjuetie me antarësimin në një shoqatë gjuetarësh. Për ata që tashmë i kanë armët dhe nuk janë anëtarë të shoqatave të gjuetarëve armët të mbyllen (vulosen) për një periudhë të pacaktuar kohore me përgjegjësi nga Policia e Shtetit dhe shoqatat e gjuetarëve. Për gjuetarët, armët të mbyllen me mbarimin e sezonit të gjuetisë dhe të hapen kur ai fillon nga shoqatat e gjuetarëve, praktikë kjo që ka ekzistuar tradicionalisht në vendin tonë. Shoqatat e gjuetarëve marrin përsipër të mbulojnë gjysmën e shpenzimit të kostos që do përballohet për vulosjen e armëve të gjahut, por duke vënë në dispozicion edhe burimet njerëzore, të zgjedhurit që kemi ne nëpër shoqata. Kemi mendimin që dokumenti për mbajtjen e lejes së armës së gjahut (kartoni) të jetë i ndryshëm sipas emërimit të armëmbajtësit. Duhet të kemi armë trofe, armë sportive, si dhe arme gjuetie. Ky dokument duhet të jepet nga komisariatet e policisë.

**Eduard Shalsi** – Zoti Perri, të lutem shkurt, sepse letrën e kemi të gjithë përpara.

**Themi Perri** - Edhe dy pika kam.

**Eduard Shalsi** – Mos i lexoni, por thoni ato dy ose tre shqetësime që keni.



**Themi Perri** – Atëherë, do të them edhe dy pika të tjera. Është e vetmja dukuri në Shqipëri që vlera e mishit dhe gjahut është e barabartë me atë të një zogut pulë në fshat, në fushë. Ne kemi propozuar që të katërfishohen tarifat e vjeljes. Nuk mund të gjuajë një gjuetar me 20 mijë lekë të vjetra, por duhet të paguajë, sepse, në fund të fundit, gjahu është pasion. Ne që kemi ardhur këtu paguajmë për të ngjallur një kënaqësi.

Ajo që mund të vendosë në ekuilibër gjuetinë në Shqipëri, krahas të tjerave është edhe bllokimi i zonave të gjuetisë, pra të bëhet një qarkullim i zonave të gjuetisë. Për shembull, le të ndalohet për një vit gjuetia në Kukës dhe të lejohet në Has. Vitin tjetër të ndalohet Hasi dhe të zhvillohet në Kukës, e kështu me radhë. Kjo do të bëjë një gjë shumë të mirë, sepse do të ripopullohen zonat e tjera me ato kafshë, shpendë dhe specie që janë në zhdukje ose janë drejt zhdukjes.

**Kujtim Hazbiu** - Zoti kryetar, për të qenë pak më koncizë, duke u marrë leje edhe kolegëve, se do të flasim të gjithë, ne mendojmë që të jemi sa më konkretë me këto pika, në lidhje me këtë problem.

Në radhë të parë, ajo që kërkojmë ne, se jemi një grup, shumica juristë, qoftë gjyqtarë apo prokurorë, që janë gjuetarë, kemi arritur në konkluzionin përfundimtar që gjuetia duhet të klasifikohet si vepër penale. Pra, deri sot me rrugën administrative nuk ka asnjë lloj zgjidhjeje. Përderisa gjuetia e peshkut klasifikohet si vepër penale, edhe gjuetia e paligjshme duhet të klasifikohet si vepër penale, me qëllimin për t'u hapur rrugën Policisë së Shtetit dhe prokurorisë për të bërë ndjekjen penale, por njëkohësisht edhe ndikimin pozitiv që ka si vepër shumë e paligjshme, kriminale dhe me shumë anë negative në Republikën e Shqipërisë. Meqenëse fauna është pronë shteti, normalisht, ne kemi menduar që të jetë vepër penale.

Problem tjetër i rëndësishëm që ne argumentojmë që të mos mbyllet gjuetia, por të ndalohet gjuetia e paligjshme me imitues, natën, jashtë sezonit të gjuetisë. Këto janë tri problemet më kyçe që shqetësojnë të gjithë vendin tonë. Problem shqetësues, duke marrë eksperiencë nga shumë shtete të botës, është fakti që një anëtar i Shoqatës së Gjuetisë, cili mund të jetë edhe gjuetar, duhet të kualifikohet, ashtu si ndodh me patentat, sepse në shumë raste na ka ndodhur që arma e gjuetisë është përdorur si armë krimi. Ka me dhjetëra raste që kanë vlarë me të. Pra, të hapen kurse kualifikimi. Në shumë vende të Europës gjuetari, përpara se të pajiset me armën e gjuetisë, duhet të kualifikohet. Në këto

kurse qëllimi kryesor duhet të jetë njohja me armët, por edhe njohja e faunës në Republikën e Shqipërisë. Të bëhet inventarizimi dhe klasifikimi i armëve të gjuetisë. Pra, përderisa e kanë emrin “armë gjuetie”, duhet të përdoren për gjueti. Klasifikimi i armëve duhet të bëhet sipas përdorimit të armës: armë gjuetie, armë trofe dhe armë për përdorim të përditshëm.

Një problem tjetër që ka qenë dhe vazhdon të jetë shqetësues dhe çorientues për ne është fakti që duhet të ketë një federatë gjuetarësh, duhet të ketë një centralizim për drejtimin uniform të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë. Pavarësisht se kush mund të jetë (sot mund të jem unë dhe nesër një tjetër), duhet të ketë jetë një federatë gjuetarësh (në çdo rreth duhet të ketë një shoqatë gjuetarësh), me qëllim që të komandohet e të disiplinohet gjuetia në çdo rreth të Republikës së Shqipërisë.

Problem tjetër është: përderisa gjuetia është një sport qejfi, ne kemi qenë të gjithë unanimitë që të rritet tarifa e gjuetisë. Kush do të bëjë gjueti, të paguajë më shumë, sepse 10 mijë lekë të vjetra mua më duken qesharake. Kur ble një zagat 2 mijë euro dhe pajisje të tjera, unë i kam dalë për zot kësaj pune. Pra, të rritet tarifa e gjuetisë. Kush të jetë i zoti, të shkojë për gjueti të ligjshme dhe me tarifa shumë më të rritura. Pra, edhe një herë, për mendimin tim, të shikohet mundësia e rritjes së tarifës së gjuetisë.

Problem tjetër shqetësues për ne, të cilin duhet ta kenë parasysh gjatë përpilimit të ligjit, është që Shoqata e Gjuetarëve duhet të jetë pjesë e vendimmarrjeve për problemet e gjuetisë. Deri më sot, tek të gjitha institucionet që japin lejet e gjuetisë, shoqata e gjuetarëve është e përjashtuar. Pra, meqenëse është palë interesi dhe pala me e afërt e gjuetisë, në çdo aktivitet dhe në çdo veprimtari që kanë lidhje me gjuetinë, shoqatat e gjuetarëve duhet të jenë vendimmarrëse për aq pjesë sa i takon, siç ka qenë historikisht dhe siç e ka e gjithë bota.

Përfundimisht, ne ndihemi komodë që kemi ardhur sot të japim këtë kontribut. U bëjmë ftesë të gjithë deputetëve, normalisht të gjithë e kanë dëshirë, sepse e njohin gjahun mirë dhe kanë pasion për shpendët, pra të mos e mbyllin gjuetinë, por ta disiplinojnë atë. Unë e quaj paaftësi shtetërore dhe institucionale nëse e mbyllim gjuetinë. A ke mundësi ta disiplinojmë?! Unë them se ka shumë mundësi për ta disiplinuar. Ne, kur u bë ligji i kaluar, propozuam që nëse shteti ka vështirësi, normalisht që ka, për

mbylljen e armëve të gjuetisë, kemi menduar t'i shtohet tarifa gjuetarit për atë armë që do t'i bllokohet.

Pra, shqetësimet kryesore ishin: ndalimi i gjuetisë së paligjshme, disiplinimi i gjuetisë, hapja e kurseve dhe marrja e masave për një centralizim të gjuetisë e drejtuesve dhe, siç e ka e gjithë bota, kërkojmë të jetë shumë kërkuar afati i gjuetisë, pra të jetë një deri në dy ditë.

Ju faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Duke ju falënderuar, ftoj kolegët e komisionit për të drejtuar pyetje.

Fjalën e ka zoti Baraj.

**Besnik Baraj** – Faleminderit!

Ggjatë fjalës suaj i dhatë një peshë specifike shumë të madhe dëmit që shkaktojnë gjuetarët e huaj. Ndërkaq ju vetë keni thënë se janë rreth 150 mijë armë. Unë dyshoj që të jetë vetëm faktori gjuetar i huaj që dëmton. Megjithatë, në këtë kontekst, a keni ndonjë vlerësim se sa është numri i gjuetarëve të huaj që vijnë në Shqipëri për gjueti?

Së dyti, ju a mund të ndihmoni dhe të informoni lidhur me speciet që janë në rrezik zhdukjeje, me qëllim që edhe ky institucion të marrë vendime për ndalimin e gjuetisë për specie të veçanta?

Meqenëse këtu ka mungesë kapacitetesh, veçanërisht për zbatimin e ligjit atë (ajo që thatë edhe ju, pra ne vërtet mund të miratojmë nesër një ligj, por ka shumë probleme për implementimin e tij), a keni ju informacion në lidhje me rolin e shoqatave të ngjashme me ju, për t'u bërë vetë implementues dhe bashkëpunues në drejtim të zbatimit të ligjit, duke marrë edhe funksione ligjore në kushtet e vendit tonë, ku mjaft struktura mungojnë?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Ju lutem, mbajini shënim pyetjet! Më pas, kur të jepni përgjigje, referojuni emrit të deputetit. Në këtë mënyrë, është më e lehtë të ndiqet radha e pyetjeve.

Fjalën e ka zoti Gaçi.

**Artan Gaçi** – Me sa kuptova unë, pavarësisht se janë një sërë problemesh, më kryesori është nevoja për një ligj organik për gjuetinë, konform Bashkimit Europian.

Pyetja ime është: Sot që ne po flasim, a ka një ligj për gjuetinë? A është zbatuar ky ligj? Këta italianë që shikojmë rëndom si në *facebook*, ashtu edhe në media, a ndalohen nga Policia e Shtetit Shqiptar kur kalojnë në Durrës ose në Vlorë? A ka ndonjë ligj që i ndalon ata? A ka funksionuar ky ligj? A ka funksionuar shteti, apo ka të bëjë me pazbatueshmërinë e ligjit?

**Eduard Shalsi** – Faleminderit!

Zoti Toçi, urdhëroni!

**Fatmir Toçi** – Përshëndetje!

Ju falënderoj për informacionin, sepse është i nevojshëm.

Unë kam një pyetje të shkurtër për të parë edhe bashkëpunimin me shoqatat e gjuetarëve. Në qoftë se ky komision, parlamenti dhe qeveria shqiptare do të merrnin një vendim që për një periudhë të shkurtër 6-mujore apo 1-vjeçare, të shpallnin një moratorium për gjuetinë që të bëhen verifikimet e duhura për disiplinimin e këtij lloj aktiviteti, rishikimin e ligjit dhe për të gjitha problemet që ju ngritët, a do të ishit mbështetës të kësaj iniciative në interes të përmirësimit të situatës?

Përveç dëmit të jashtëzakonshëm që po bëjnë gjuetarët e pandërgjegjshëm, duke shkelur ligjin, është edhe zhvillimi joproporcional i kafshëve të ndryshme. Sot i gjithë populli po ankohet se janë shtuar shumë kafshë grabitqare dhe kjo përbën rrezik për jetën e njerëzve. Madje shpopullimi në këto zona të banuara drejt qyteteve ka ardhur si pasojë e shtimit të gjarpërinjve dhe ujçërve.

Në kohën e kooperativave ka pasur një rregull. Nuk e di nëse ka qenë ligj apo rregull i brendshëm. Në atë kohë gjahtarët ishin të stimuluar për rrallimin e këtyre specieve. Në bazë të vrasjeve që ata kryenin, për shembull, për ujçërit, merrnin një sasi pikësh dhe kooperativa i shpërblente me ndonjë qengj ose me ndonjë gjë tjetër.

Pyetja ime është: A mendoni se janë të nevojshme sot masa të tilla? A mund të realizohen nëse do të propozohet ndonjë ligj i tillë? Sepse këto kafshë përbëjnë një rrezik për jetën e njeriut në këto qendra të banuara.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit!

Zoti Papa, urdhëroni!

**Gjergji Papa** – Faleminderit, zoti kryetar!

Fillimisht dua t'ju falënderoj për prezantimin mjaft të mirë që bëni dhe bashkohem me të gjitha shqetësimet tuaja.

Dua t'ju bëj një pyetje: Çfarë mendoni për ruajtjen e faunës së egër në Shqipëri? Është më mirë të forcohet kontrolli për gjuetinë e paligjshme apo ndalimi i gjuetisë me një afat të caktuar?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit!

Zoti Koplaku, urdhëroni!

**Namik Koplaku** – Faleminderit!

Ju treguat një fotografi që ne të shikonim se sa gjah kishin arritur të gjuanin gjuetarët turistë të huaj, të cilët krenohen.

Pyetja ime është kjo: Ju kur gjuani vetë, a vrisni kaq shpesh? Çfarë ju ndalon të vrisni kaq shpesh? Jeni të paaftë apo jeni të ndërgjegjshëm?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Si ka mundësi? Dilni për gjueti dhe në një moment të caktuar thoni: nuk vras më, se kam vrrarë shumë.

Moratorium do të thotë: të ndalojmë kasaphanën në faunën e egër në Shqipëri. Ashtu si shoqata juaj homologe, që ishte herën e kaluar, edhe ju thoni se të huajt po bëjnë kërdinë.

Zoti Baraj me të drejtë pyeti: Sa të huaj janë dhe sa jeni ju? Ju thatë se në shoqatën tuaj janë 17 mijë gjuetarë. Ndërsa, kolegët tuaj, herën e kaluar, thanë se janë 4 mijë të abonuar që paguajnë kuota.

Pra, ju jeni 17 mijë gjuetarë të ligjshëm. Ndërsa, shoqata tjetër thotë se ka edhe 17 mijë të tjerë. Gjithashtu, ka edhe një numër të madh gjuetarësh, që nuk regjistrohen në asnjë shoqatë. Kush po e dëmton faunën e egër në Shqipëri, të huajt që shkojnë për gjueti, apo edhe ju? Kush mund ta ndalojë shkatërrimin e faunës së egër në Shqipëri përveç moratoriumit?

Ju dhatë mjaft alternativa qoftë për gjueti 2 herë në javë, qoftë për masat restriktive kur shteti konstaton gjueti të paligjshme, qoftë për dyllosjen e armëve të gjahut jashtë periudhës së lejuar të gjuetisë. Të gjitha këto alternativa kanë qenë teorikisht, vetëm se nuk kanë funksionuar, prandaj ne po shkojmë drejt shkatërrimit të saj.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Zoti Dashi, urdhëroni!

**Kozma Dashi** – Së pari, ju falënderoj për paraqitjen që bëtë, por këtu ka diçka që nuk shkon. Ju theksuat se gjahtarët ndahen në të mirë dhe në të këqij. Ata thanë me shifra se janë 17 mijë gjuetarë, të cilët janë të kontrolluar dhe paguajnë taksa, jo pak, por rreth 200 milionë. Gjithashtu, thanë se gjahtarët me armë që kanë licencë dhe që paguajnë taksa janë rreth 4 mijë.

Pyetja e parë: A paguajnë taksë këta 17 mijë anëtarë që keni? Sa është vlera e taksës?

Së dyti, ideja që tha zotëria më pëlqeu dhe jam dakord që kush kërkon një shërbim duhet ta paguajë, por, siç thatë edhe ju, taksa që paguhet është qesharake dhe nuk pranohet.

Pyetja ime është kjo: Sa e mendoni vlerën, duke parë edhe eksperiencën e vendeve në Europë? Sepse është vërtet qesharake.

Së treti, agjencia tjetër na tha 4 mijë, ju nxorët 17 mijë. Për këtë dua një përgjigje. Sa vetë janë të taksuar nga këta 17 mijë? A nuk mendoni se ka diçka që nuk shkon? Ka 17 mijë anëtarë që zotërojnë çifte me leje dhe 100 e ca mijë të tjerë që zotërojnë armë pa leje. Çfarë propozoni ju? Mos duhet që problemi të shikohet dhe të kthehet nga moratorium i gjahut në moratorium të armëve?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zoti Dashi!

Urdhëroni, zoti Bitri!

**Robert Bitri** – Pyetja ime e parë është kjo: ju jeni 17 000 gjahtarë, 4000 janë ata të tjerët, i bie 21 000, a keni bërë ju ndonjë lloj studimi nëse ky numër është i pranueshëm apo duhet të jetë i kufizuar ose i shtuar kundrejt armëve që ne kemi në dispozicion të qytetarëve shqiptarë, të cilët janë 150 000? A keni bërë ndonjë studim se sa duhet të jetë numri i gjahtarëve që duhet të lejohen? Po ashtu të sanksionohet që të drejtën e lejes ta japë federata juaj, quheni shoqata apo federata, si të doni, por të ketë një në Shqipëri. Besoj se ky është edhe propozimi juaj. E mira është që të ketë një shoqatë, me qëllim që askush të mos ketë të drejtën të qëllojë nëse nuk do të jetë pjesëtar i shoqatës. Në këtë

mënyrë kontrollohen armët, pagesat, si dhe se sa të ardhura përfitojmë apo se sa të këqija bëjmë. Pra, a mos është më mirë që ne ta kemi edhe këtë të kufizuar nga federata?

Pyetja e dytë: a është më mirë që në ligjin që kemi të përmirësojmë sanksionin, që pa dhënë lejen ju të mos ketë të drejtë askush të mbajë armë apo të përdorë armë për gjueti?

**Eduard Shalsi** – Atëherë, fillojmë me përgjigjet.

Po, zoti Perri.

**Them Perri** – Zoti Besnik pyet nëse ka ndonjë shifër për numrin e gjuetarëve të huaj; çfarë shpendësh e speciesh janë në rrezik zhdukjeje dhe cili është roli i shoqatave të gjuetarëve në këtë drejtim?

Unë ju them se nuk ka një shifër të saktë për ardhjen e gjuetarëve të huaj në Shqipëri. Këtë vit janë regjistruar 8 agjenci, të cilat paguajnë një shumë prej 8 milionë lekësh secila, për të ushtruar aktivitetin e tyre dhe nuk i dihet paguajnë apo jo tatime, TVSH dhe detyrime të tjera. Unë mendoj se agjencitë turistike, pra të gjuetarëve të huaj, sidomos gjatë viteve të fundit kanë marrë përmasat e kazinove. Në qoftë se janë 8 agjenci të licencuara, mund të jenë 30 që punojnë në të zezë. Unë kam marrë pjesë në grupet e kontrollit të task-forcës së Ministrisë së Mjedisit dhe po ju them se fusha e Myzeqesë nga Fieri, Lushnja, si dhe Lezha e të gjitha me radhë, mbushen vetëm me gjuetarë të huaj. Ne i kemi parë vetë. E shikojmë me sy realitetin dhe jo me shifra, dhe jo nga zyrat. Pra, nuk ka një numër të saktë. Unë po ju them se pushtohen nga gjuetarët e huaj, sidomos në muajt gusht, shtator, tetor deri në gjysmën e nëntorit. Nuk kemi ndonjë shifër të saktë, por ka shumë. Me këtë dua të them që edhe kur është ditë e ndaluar për gjueti, për shembull dita e martë, sikur të kemi mundësi të shkojmë atë ditë në malin e Trebeshinës, do të gjejmë një kryetar komune që ka vënë një tra dhe e ka kthyer në çifligun e vet dhe u thotë gjuetarët grekë e italianë: “Hajdeni dhe gjuani”. E ka kthyer në pronë të vetën. Kjo është shumë e saktë.

Për sa u përket specieve në rrezik, po ju them se kur gjuan gjuetari i huaj në Shqipëri, ai nuk vë re fare se çfarë gjuan, një zog lareshë, që ata e kanë shumë qejf, apo jo, pra çdo gjë që fluturon ata dëshirojnë ta vrasin. Më e keqja është, nuk e di nëse e dini apo jo, që gjahu shqiptar nuk lejohet të hyjë në Itali. Hyn vetëm në mënyrë klandestine. Gjuetarët vijnë këtu, vrasin gjahun, kurse sekserët këtu në Shqipëri e paketojnë dhe e

nisin kryesisht me autobuza ose me traget. Asnjë gjuetar italian nuk kthehet nga gjuetia me gjahun dhe të shkojë në Itali. Rasti më i fundit ka qenë para dy javësh kur u kap një grup gjuetarësh italianë me 17 thëllëza në Bari të Italisë dhe u dënuan me 30 mijë euro gjobë, me sekuestrim makinash e armësh. Domethënë, gjahu ynë nuk lejohet të futet në Itali. Pse duhet që ne t'i japim zë gjuetisë së të huajve? Përse duhet të vijë gjuetari i huaj këtu, përderisa ai gjahun e çon andej?

Pyetja tjetër: a rrezikohen speciet? Po, rrezikohen. Në Shqipëri nuk ka më thëllëza fushe që nga Velipoja e deri në Vlorë. Ne dhe shoqatat e gjuetarëve, me atë fukarallëkun e madh që kanë, jemi munduar të bëjmë diçka. Para dy vjetësh iu morëm gjuetarëve tanë në zonën e Gradishtës së Lushnjës nga 5000 lekë dhe morëm fazanin, i cili ishte zhdukur, dhe e çuam në Gradishtë të Lushnjës. Zogu i fazanit ishte 12-javësh dhe ne e paguam sikur po fusnim pula nga Maqedonia, pra paguam shumë lekë në doganë. E lamë aty një vit dhe lulëzoi. U bënë disa emisione, por grabitqarët na e zhdukën, dhe jo ujku e dhelpra, por këta të tjerët.

Pyetja tjetër: a ka një ligj për gjuetinë?

Ne kemi ardhur edhe më parë në Komisionin për Veprimtarive Prodhuese dhe kemi dhënë mendimet tona, të cilat u pritën shumë mirë, por kur erdhi puna, asnjë presje nuk u vendos nga rekomandimet tona. Ligji i gjuetisë e ka zhveshur shoqatën dhe federatën e gjuetarëve nga çdo atribut. Ne jemi kot. Ne mbahemi falë dëshirës sonë, përkushtimit, si dhe traditës së mirë që kemi pasur ndër vite. Për mendimin tonë, ne nuk duhet të merremi me emra, por federata që u paraqit pardje është federatë anonime. Ajo nuk ka as 400 anëtarë e jo më 4000. Kur vijmë këtu dhe raportojmë para jush, deputetë të nderuar, ne vijmë me bilance. Ne kemi bilancet e 38 shoqatave të gjuetarëve, që janë bilance ekonomike e financiare, të cilat tregojnë se ku ka shkuar edhe qindarka e fundit. Ne nuk vijmë të themi kemi 4000, 17000 apo 20 000. Kështu që ajo federatë apo ajo shoqatë është për ta vendosur nën rrotat e Federatës së Gjuetarëve të Shqipërisë.

Si është ndërtuar? Është ndërtuar në këtë mënyrë: përjashtonte kryetari i shoqatës së gjuetarëve në Beratit 5 veta, sepse gjuanin natën me projektorë, (ka një ligj për funksionimin e organizatave joqeveritare të vitit 2001, i cili është komplet jashtë loje) këta 5 veta kanë të drejtën të krijojnë një shoqatë gjuetarësh. Pesë gjuetarët e këtij zotërisë bënë një shoqatë dhe u bashkuan me këtë federatë dhe ai kënaqet, duke thënë:



“Krijova edhe një degë në Berat”. U shkarkua një sekretar shoqate në Krujë, sepse vodhi lekët e anëtarësisë, ai mblodhi 5 veta dhe bëri një shoqatë që u bashkua me këtë federatë. Kjo është një e keqe shumë e madhe.

**Kujtim Hazbiu** – Tani le të flasim për ligjin, sepse po dalim jashtë teme. Pyetja që bëri zoti Gaçi është pjesë shumë e rëndësishme e debatit që po bëjmë dhe e pjesës për disiplinim e gjuetisë në Shqipëri. Pra, ai që rregullon këtë problem është ligji. Ne duhet të përqendrohemi në ato pika që janë shqetësuese të ligji.

E para, ligji ekziston, zoti Gaçi, por nuk ka funksionuar. Në një debat televiziv që kemi bërë, unë ua kam bërë këtë pyetje të gjitha drejtorive pyjore nëpër rrethe, por edhe Ministrisë së Mjedisit, pra çfarë masash janë marrë për gjuetinë e paligjshme? Ju garantoj se në të gjithë Shqipërinë janë 9 raste, të cilat edhe gjobat administrative që kanë marrë, sipas parashikimeve të ligjit, nuk i kanë zbatuar. Prandaj, ne ngulëm këmbë që gjuetia e paligjshme të jetë vepër penale.

Për sa i përket ligjit, problem tjetër shqetësues që ne kemi, si federatë gjuetarësh, është se Shoqata e Gjuetarëve të Republikës së Shqipërisë duhet të jetë një e vetme, duhet të jetë pjesë e vendimmarrjeve në lidhje me problemet e gjuetisë. Shembull konkret kemi Maqedoninë, ku rojtarët e pyjeve për problemet e gjuetisë janë përfaqësues të Shoqatës së Gjuetarëve dhe financohen nga shteti, nga shoqata; një problem që mund ta zgjidhni ju dhe ligji. Pra, ligji ka qenë, por nuk ka funksionuar me të mirat dhe më të këqijat e veta. Ligji nuk ka qenë pjesë e vendimmarrjeve në Shoqatën e Gjuetarëve dhe problemi më shqetësues është disiplinimi i armëve të gjuetisë.

Pra, 3 janë problemet kryesore: zbatimi me korrektesë të ligjit, disiplinimi i armëve të gjuetisë, si dhe pjesëmarrja e Federatës së Gjuetarëve në vendimmarrje lidhur me këtë problem. Këto janë pikat kryesore të ligjit.

**Them Perri** – Kemi edhe një pyetje tjetër: po u shpallën moratoriume, a do të kemi mbështetje?

Patjetër që do të ketë mbështetje. Ne, gjuetarët që jemi këtu, jemi të moshave të ndryshme, me bindje të ndryshme, por ama kur veshim xhaketën dhe hedhim pushkën në krah, jemi të gjithë njëloj. Ne çdo lloj vendimi, çdo nismë, kushdo forcë politike, që do të jetë në pushtet, do ta mbështesim. Por më e mira për ne, që do të kishte më shumë efikasitet, e përmendi zoti Papa, është që të ketë një kontroll të rreptë të gjuetisë. Gjuetia

duhet të qeveriset me një diktaturë të fortë, nuk po flas për diktaturën e Enverit. Kur them diktaturë të fortë themi që duhet të ketë një rregull të fortë. Ju nuk keni pse e politizoni në këtë formë. Në qoftë se nuk arrijmë që të vulosen armët e gjahut është e kotë që flasim për gjëra të tjera. Duhet të vulosen armët e gjahut, të bëhen klasifikimet dhe më pas të disiplinohen ato.

Çfarë do të bëni për ujkun dhe për dhelprën? Me ligj këto kafshë janë të ndaluara për t'u vrrarë, dhe duhet rregulluar me ligj.

Kush paguan? Ne themi se numri i anëtarësisë së shoqatave të gjuetarëve, kemi 38 të tilla me vendime gjykate, varion nga 12 mijë deri në 17 mijë vetë, varet nga viti. Për shembull, sivjet ne kemi një rënie drastike të numrit të anëtarësisë, sepse nuk po kërkon njeri llogari. Shifra 4 mijë gjuetarë nuk është e rregullt, zoti Poni, sepse vjet rreth 8 mijë gjuetarë kanë paguar detyrimet shtetërore, brenda dhe jashtë rrethit. Vetëm sivjet në 3 rrethe kanë paguar mbi 2 mijë e 500 anëtarë. Nga Shkodra, Durrësi, Gjirokastra dhe Lushnja kanë paguar mbi 2 mijë e 500 anëtarë shoqate. Pse e kanë bërë këtë? Sepse drejtoritë e shërbimit pyjor bashkëpunojnë me shoqatat e gjuetarëve dhe kanë dalë me idenë: një gjuetar, një leje gjuetie.

Ku gjuhet më shumë? Në Has, Kukës, Bulqizë, Dibër, në rrethet Verilindore e Lindore. Absolutisht, në drejtoritë e shërbimit pyjor i kalojnë apo nuk i kalojnë 5 leje gjuetie.

Për sa i përket numrit të anëtarësisë, që është 17 mijë dhe 4 mijë që e kanë deklaruar zotërinjtë, nuk është e vërtetë. Në qoftë se ata zotërinjtë bien ndonjë evidencë dhe i kalojnë 400 anëtarë, ne mbajmë përgjegjësi. Ne i kemi me bilance. Ajo federatë ose shoqatë është krijuar për interesa të ngushta, për të punësuar një njeri në kohën e atëhershme, që si i thonë asaj fjalës së urtë popullore: “T’i gjesh Kolës punë, apo Kola të jetë në punë”!

**Eduard Shalsi** – Po zoti Mustafaj.

**Zyhdi Mustafaj** – Ne kemi nderin më të madh që ndodhemi sot në këtë mbledhje të jashtëzakonshme për Shoqatën e Gjuetarëve, sepse pas 70 vjetësh të krijimit të Federatës së Shqipërisë është bërë e mundur nga ju ky takim. Ne e quajmë dhe special takimin e sotëm. Ngaqë jam nga Shkodra dhe zoti Koplaku gjithashtu, dhe e di shumë mirë situatën atje, e di shumë mirë se sa emisione televizive kam bërë unë si kryetar i

shoqatës së Shkodrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë dhe Drejtorinë Pyjore për Gjuetinë e Paligjshme, që është bërë një gangrenë në Shkodër, sepse është pika kryesore hyrëse e të gjitha shpendëve migratorë që futen në territorin e Shqipërisë.

Do t'i referohem zotit Kopliku për një arsye që tha se cila është kurajo juaj? A jeni më të paaftë se italianët që bëni gjueti aq pak, apo ka një arsye tjetër?

E kuptoj plotësisht pyetjen tuaj zoti Kopliku, por gjuetia ka lindur njësoj me njeriun. Pra, përderisa gjahu ka lindur që kur ka lindur njeriu, atëherë ne jemi pasardhës të atyre që e kanë sjellë gjahun deri në ditët e sotme. Dhe asnjë gjuetar i Republikës së Shqipërisë, që aderon në Federatën e Gjuetarëve të Shqipërisë nuk del jashtë limiteve të gjuetisë, në një ditë gjuetie që bën. Asnjë gjuetar, që e quan veten të tillë, nuk del për të bërë gjah, për monopol, por del për të gjuajtur, për të shfryrë egon e vet, sportin e vet, sepse gjuetia është i vetmi sport që grumbullon të gjitha moshat. Pra, duke grumbulluar të gjitha moshat, respektivisht që është një sport i cili u dedikohet të gjithë njerëzve.

Ne jemi në gjendje t'i bëjmë barrikada kësaj gjuetie. Gjuetarët italianë që vijnë në Shqipëri, në Itali gjahun e çojnë në mënyra të ndryshme, që e dinë ata, por është një tjetër më gangrenë që ndodh, që ne i kemi kapur, kemi statistika që, këta gjuetarë që vijnë nga Italia, nuk marrin armë me vete dhe shfrytëzojnë të gjitha armët që janë në territorin e Shqipërisë, që janë të kundërligjshme. Ne themi se duhet të ketë penaltete për këtë problem, sepse ata bëjnë një gjueti me armë pa leje; ajo quhet armëmbajtje pa leje. Ne dhe anëtarët e shoqatës sonë kërkojmë që të respektohet mosha 22 vjeç, sipas ligjit, që të kenë një armë gjahu dhe të jenë të aderuar nëpër shoqatat e gjuetarëve, të respektojnë rregullat e gjuetisë dhe kalendarin e gjuetisë, sipas datave të caktuara, duke filluar nga 15 gushti e me radhë, sipas specieve që janë në periudhën e gjuetisë. Pra, ne jemi palë me shtetin, me ju, me këdo që mbron të drejtat e gjuetisë, mbron e faunën e egër në territorin e Shqipërisë.

Faleminderit!

**Kujtim Hazbiu** – Zoti Papa, se e kishe merak përgjigjen, nuk është e vërtetë se kemi ardhur këtu dhe po bëjmë profetin, ne jemi më të përsosur nga të gjithë. Ne kemi gabime kolosale në lidhje me anëtarët e shoqatave të gjuetarëve, ne kemi shfarosës. Pra, po ta shohim me kujdes edhe nga ne ka gjuetarë që e përdorin gjuetinë për interesa personale, për tregti, dëmtojnë pa masë, prandaj edhe këmbëngulim të disiplinohet ligji,

të kufizohet numri i kafshëve dhe i shpendëve që vriten. Unë kam gjuajtur dhe në Itali, dhe ata mbajnë një regjistër me vete, një librezë të vogël, ku shënojnë një copë dhe nëse kapet se vret dy copë penalizohet. Prandaj kërkohet të disiplinohet kjo gjë, sepse ne të gjithë jemi shfarosës. Edhe ne këtu, nga pasioni madh atje bëjmë gabime.

Faleminderit!

**Asti Hanxhari** - Faleminderit që na krijuat mundësinë të dëgjohemi! Ne jemi përfaqësues të Shoqatës së Gjuetarëve, që ka 70 vjet që është krijuar. Gjuetia është prishur nga viti 1977, pasi e dimë se edhe çobani mori armë dhe e la kërrabën, dhe ligjet u dobësuan. Pas pak kohësh filluan të blihen armë gjahu, për të pasur një armë në krah. Armët e gjahut u morën shumë thjesht dhe pa procedura si dikur, ndaj Shoqata e Gjuetarëve doli jashtë loje. Për ta kontrolluar gjuetarin shqiptar është shumë e lehtë: mjafton të bësh ligjet që kanë qenë, dhe jo më të përforcohen ato. Kuotizacionet e një gjuetari qoftë për anëtarësi, qoftë për ndërmarrjen pyjore janë qesharake. Shifra duhet të rritet dhe të mos jetë 110 mijë lekët të vjetra për të gjuajtur në të gjithë Shqipërinë.

Keqbërësit u shtuan në këto vite, sepse u krijuan grupe për të bërë agjencitë, u krijuan dyqane armësh dhe filluan të shiten ato mbi bazë numrin e anëtarëve që nuk ekziston. Kjo është një gjë që e prish gjuetinë në Shqipëri. Nuk ka nevojë asnjë i huaj të vijë të gjuajë Shqipëri. Neve në Itali nuk na lejojnë as të prekim armën me dorë, ndërsa këtu ka gjuetarë italianë që kanë lënë nga 2 apo tre çifte të paregjistruara. Agjencitë turistike e shpartalluan gjahun në Shqipëri.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Duke ju falënderuar për mendimet tuaja, ka ndonjë koleg që do të bëjë koment.

Urdhëroni zoti Dashi!

**Kozma Dashi** - Është një konfuzion shumë i madh për këtë çështje. U interesova dhe pashë legjislacionin italian. Dhe them se ligji i vitit 2010 duhet ta kishte theksuar që ligji si kornizë është i plotë, por ju duhet të pranoni se ligjin e kemi si kudo në Europë, me ndryshime të vogla, por jo se po na e ngatërron këtë punë ligji. Për pyetjet që bëra, sërish nuk m'u përgjigjet. Njëherë më thatë 7 mijë anëtarë, pastaj 8 mijë, pastaj e ndryshuat sipas vitit dhe për këtë vit s'm'u tha sa janë regjistruar.

Duhet të dini përgjegjësitë tuaja. Ne kemi 140 mijë të padisiplunar me armë dhe një farë ndikimi duhet të kishte këtu edhe puna juaj. Unë ngul këmbë se, ajo masakër që ju përmendët dhe hodhët të gjithë tek ata, logjika e thjeshtë ta do që një pjesë e kësaj masakre jeni edhe ju. Mesa kuptova, ju e kishit përgjigjen e plotë dhe i thoni qeverisë që të mos vendoset moratoriumit. Unë bashkohem me këtë dhe i rri faktit që kush paguan do marrë edhe shërbimin.

Është katastrofike situata dhe duhet të merren masa urgjente që këto 150 mijë armë të jenë të kontrolluara. Ju keni përgjegjësinë tuaj, se e dini shumë mirë që kudo që të dalësh gjen fshatarë me çifte rrugës në çdo sezon. Ideja ime është të disiplinohen përmes moratoriumit armët e pakontrolluara dhe të kontrollohen ato që janë. Ligji është i plotë ndaj duhet t'i mëshojmë zbatimit të tij.

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zoti Dashi!

Zoti Tahiri, urdhëroni!

**Dashamir Tahiri** – Nuk jeni në shoqatën e gjuetarëve këtu. Mësoni rregullat! Ju falënderoj të gjithëve! Ju dëgjova me respekt. Unë kam shumë miq dhe vetë gjuaj ndonjëherë kur kam kohë. Unë jam kundër moratoriumit. Ato nuk kanë dalë shumë të suksesshme në Shqipëri. Ai që është nisur të bëjë kontrabandë do ta bëjë, ai që do të gjuajë pa leje, do gjuajë ashtu, ne jemi të detyruar ta zbatojmë ligjin dhe të ndëshkojmë shkeljet e tij. Të dënohet kushdo që del për gjah jashtë sezonit.

Së dyti, do t'u sugjeroja zotërinjve të bëhet një pjesë ligji, ku të jetë reciprocitet. Në qoftë se një gjahtar shqiptar lejohet të gjuajë në Itali apo në Greqi a në Gjermani, duhet të jemi të barabartë dhe vetëm atëherë të vijjnë ata të gjuajnë këtu. Nëse nuk ka barazi këtu, kjo të hiqet.

Së treti, doja të shtoja se ne duhet të jemi më praktikë dhe të mos merremi me: “shfarosi, vrau, preu, dyfeku” dhe histori të tjera kot, që nuk na sjellin asgjë, por na mbajnë në zhurmën e 22 vjetëve. Fajtoje janë të dyja forcat politike; të majtët dhe të djathtët. Ligji ka nevojë të respektohet. Nuk duhet bërë asgjë tjetër, por të ndahen zonat e gjuetisë në bazë të shoqatave, ku secila të ketë rezervatet e saj dhe të bëhen pjesë e ruajtjes së tyre; të mbështeten nga Policia Pyjore dhe Policia e Shtetit.

Unë mendoj se do të jetë më praktike kjo, sepse këto janë grupet e interesit që e ruajnë më shumë gjahun.

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zoti Tahiri!

Zoti Cara, urdhëroni!

**Parid Cara** – Ju falënderoj për informacionet që na dhatë këtu. Jam i bindur që nuk janë vetëm gjuetarët e huaj që e shkatërrojnë faunën në Shqipëri, problem janë armët, për të cilat diskutoi edhe kolegu më parë, që janë të palicencuara. Vetëm në Kavajë kemi 2500 armë gjuetie dhe gjuetarë të licencuar janë mbi 150 persona.

Më vjen shumë keq për ato fotografitë që treguat më parë, kur ne e dimë shumë mirë. Unë kam jetuar në Itali shumë vite dhe i kam respektuar ligjet. E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe këtu. Edhe ata që vijnë në Shqipëri duhet t'i ndjekin dhe t'i zbatojnë ligjet tona.

Nuk jam dakord për moratoriumin, por jam me idenë se duhet të ushtrojmë më tepër kontrollë dhe të kemi bashkëpunim edhe nga ana juaj për ushtrimin e këtyre kontrolleve.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Zoti Baraj, urdhëroni!

**Besnik Baraj** – Personalisht, unë jam për moratorium të pjesshëm. Përsa kohë ne nuk kemi zbatueshmëri të ligjit, përsa kohë gjuetarët vetë me njëri-tjetrin nuk kanë ngritur struktura që të bëhen edhe këto pengesë për këtë masakër që po i bëhet faunës në Shqipëri, veçanërisht në zonat sensitive, unë mendoj se duhet të ketë moratorium deri në rigjallërimin nga pikëpamja sasiore të specieve në këto zona, gjë që, pak a shumë, edhe ju e pasqyruat. Nëse do të bëhet një moratorium, duhet punuar me shpejtësi për adaptimin e legjislacionit dhe ngritjen e të gjitha kapaciteteve që ta bëjnë të zbatueshëm këtë ligj. Përndryshe, ligjet, si shumica në Shqipëri, do të ngelen thjesht një dekor, nuk do të kenë ndonjë vlerë, dhe situata po përsëri do të jetë dramatike.

Për këtë duhet pa dyshim një bashkëpunim shumë i fortë ndërmjet jush, strukturave përkatëse shtetërore, pa dyshim dhe Parlamentit, që të ndryshohet edhe Kodi Penal në lidhje me atë që thatë ju, që të konsiderohet krim, veçanërisht kur gjuhen specie që janë të rrezikuara ose janë jashtë sezonit.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zoti Baraj!

Unë mendoj se problemet janë të qarta. Situata është jashtë kontrollit dhe krejtësisht kaotike. Qoftë në takimin e sotëm, qoftë në takimin e javës që kaloi, në qoftë se ka një gjë që konvergojnë të gjitha palët, është pikërisht situata jashtë kontrollit.

Në fakt, ju shpreheni, sikundër u shprehën edhe disa kolegë të mi, kundër moratoriumit, por argumentet që jepen thonë që duhet një fazë tranzitore, të cilën, unë personalisht, nuk e shoh ndryshe nga një frenim, bllokim apo pezullim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po flasim për pjesën e gjuetisë. Tri janë pikat kryesore:

Ju thoni që ligji duhet rishikuar. Në kontekstin e ligjit duhet parë edhe mënyra e organizimit. Për mua është e papranueshme që të ekzistojnë dy federata, shoqata, dhe ne sot që flasim të mos kemi një inventar adekuat të të gjithë Shqipërisë (dikush thotë 150 mijë armë, dikush tjetër thotë 120 mijë). Ne nuk dimë sa gjuetarë kemi. Ne nuk dimë sa armë kemi. Ne kemi mospërputhje midis dokumenteve të lëshuara nga komisariatet e policisë për armë dhe atyre të deklaruara. Pra, në këtë situatë kaosi gjithmonë fillohet nga një inventarizim. Pra, rishikimi i ligjit në diskutim edhe me përfaqësuesit e shoqatës së Bashkimit European, eksperiencia e të cilëve mund të jetë shumë e vlefshme për të sheshuar të gjitha mospërputhjet midis shoqatave.

Unë jam i bindur që pavarësisht nga kundërshtimet, njerëzit që duan të gjuajnë në mënyrë të ligjshme, kanë më shumë gjëra të përbashkëta se sa gjëra që i ndajnë. E pra, hajde ta fillojmë me një mënyrë tjetër organizimi! Pra, ligji, mënyra e organizimit dhe inventari, ku duhet përcaktuar shumë qartë se cili është autoriteti që jep lejen e armës, lejen e gjuetisë. Janë imediate. Pastaj çështja e tarifave dhe çështjet e tjera janë çështje të cilat mund të zhvillohen me faza.

Për çfarë politika gjuetie mund të flasim ne në Shqipëri, ndërkohë që ne nuk dimë sa janë gjuetarë? Pak më parë pyeta: “Në qoftë se dikush do të shkojë të gjuajë në Kukës, si shkon? Nga e merr lejen? Po në qoftë se 100 gjuetarë në mënyrë të pavarur shkojnë dhe përqendrohen në një zonë si Kukësi, kush i menaxhon? Kush i koordinon? Kush i shpërndan?”. Kjo ishte e përcaktuar deri diku në ligj, jo plotësisht do të thosha, sepse edhe aty kishte mangësi dhe mospërputhje me çfarë më shpjeguan. Pra, ka nevojë për një situatë, ka nevojë për një rregullim të përgjithshëm të situatës, gjë e cila nuk mund të

ndodhë ndërkohë që ne jemi në një situatë emergjente për shkak të ndërhyrjes pa kriter që po bëhet në faunën e Shqipërisë.

Gjithsesi, ne kemi mbajtur shënim dhe ju kemi dëgjuar me shumë vëmendje. Në praktikën e këtij komisioni tashmë është që edhe në përfundim të mbledhjeve ne i kërkojmë dhe i dërgojmë relacion qeverisë, ministrisë përkatëse, por edhe Kryeministrisë, në lidhje me problematikën e evidentuar, me shqetësimet, pse jo, duke i rekomanduar edhe disa nga sugjerimet që ju bëtë ose masat të cilat duhet të merren.

Edhe njëherë, duke ju falënderuar, duke falënderuar edhe kolegët, shpresoj që të takohemi për diskutimin e ligjit dhe për të parë se çfarë nga shqetësimet tuaja janë adresuar nga qeveria.

Faleminderit!

## **MBLEDHJA MBYLLET**

**Sekretar  
Robert Bitri**

**Përgjegjëse e komisioneve parlamentare  
Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit  
Valbona Miho**